



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**  
**BORDI DREJTUES**

**VENDIM**

NR. 3, DATË 17/08 2019

**PËR**

**MIRATIMIN E NIVELEVE TË PAGAVE DHE TË STRUKTURËS E ORGANIKËS SË  
AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 4 dhe të nenit 11, të Ligjit Nr. 10303, datë 15/07/2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”,

**BORDI DREJTUES**

**VENDOSI:**

1. Kategoritë e pagave dhe grupet e diplomave për nëpunësit e AIDA, të jenë sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Elementët e pagës janë si vijon:
  - a- Paga e grupit;
  - b- Shtesa për vjetërsi në punë;
  - c- Shtesa për pozicion.
3. Për natyrë të veçantë pune jepet një shtesë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, si vijon:
  - a- Nëpunësi në pozicionin “Titullar i AIDA-s”, në masën 20.000 (njëzetëmijë) lekë/muaj.
  - b- Nëpunësit në pozicionet “Drejtore” të drejtorive të përmbajtjes, në masën 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë/muaj.
  - c- Nëpunësit në pozicionet “Përgjegjës Sektori” në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes, në masën 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë)lekë/muaj.
  - d- Nëpunësit në pozicionet “Specialist”, në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes në masën 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë/muaj.
4. Klasat e pagave të punonjësve administrativë të AIDA-s, të jenë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Vlerat për secilin element të kategorive IV-b, IV-a, III-b, III-a/1, III-a, II-b dhe II-a, të jenë sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**  
**BORDI DREJTUES**

6. Vlerat e pagës bazë për klasë për punonjësit administrativë, të jenë sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështesës të institucioneve buxhetore (sistemi me 10 klasa).
7. Punonjësit administrativë, për të cilët klasa e pagës është sipas pikës 4 të këtij vendimi, përveç pagës bazë për klasë, përfitojnë shtesë për vjetërsi dhe shtesat e tjera sipas përcaktimeve të vlerave, kushteve dhe kriterëve për të njëjtat emërtesa, të vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.
8. Struktura e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të jetë sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
9. Organika e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të jetë sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
10. Numri i punonjësve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të jetë gjithësej 39 veta.
11. Struktura dhe organika e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, miratuar me vendimin Nr. 1, datë 12.01.2016, të Bordit Drejtues, shfuqizohet.
12. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Ekonomisë për trajtimin me prioritet dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme të akteve nënligjore mbi numrin e punonjësve për fondin e pagave dhe alokimin e buxhetit të ri të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.
13. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv i AIDA që brenda 30 (tridhjetë) ditësh të propozojë për diskutim në Bordin Drejtues:
  - a) Statutin e Ri të Agjencisë
  - b) Rregulloren e re të Agjencisë
  - c) Logon e re të Agjencisë
  - d) Listën e akteve ligjore/ nënligjore që mund të preken nga këto ndryshime.
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga momenti i transferimit të nëpunësve në pozicionet e reja.

**KRYETAR I BORDIT DREJTUES AIDA**

**EDI RAMA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCave DHE EKONOMISË  
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE  
BORDI DREJTUES

**MINISTËR I FINANCave DHE EKONOMISË**

ANILA DENAJ

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

BLEDI ÇUÇI

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

BLENDI KLOSI

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

**KRYETARI BASHKIMIT TË DHOMAVE TË TREGTISË DHE INDUSTRIË**

INES MUÇOSTEPA

**DREJTOR EKZEKUTIV I INTESA SANPAOLO BANK**

SILVIO PEDRAZZI

**DREJTOR EKZEKUTIV I SHOQËRISË "TRANZIT" SH.A**

ANDI BALLTA

**PRESIDENT I BIZNES ALBANIA**

LUAN BREGASI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE  
BORDI DREJTUES

Lidhja nr. 1

**Kategoritë e pagave për nëpunësit e AIDA-s**

| POZICIONI                                     | KATEGORITË | Grupi i Diplomës |
|-----------------------------------------------|------------|------------------|
| Titullar i AIDA-s.                            | II-a       | 1                |
| Drejtor drejtorie.                            | II-b       | 1                |
| Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes. | III-a      | 1                |
| Përgjegjës sektori.                           | III-a/1    | 1                |
| Specialist në sektorët e përmbajtjes.         | III-b      | 1 ose 2 ose 3    |
| Specialist.                                   | IV-a       | 1 ose 2 ose 3    |
|                                               | IV-b       | 1 ose 2 ose 3    |

Lidhja nr. 2

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës                                                                                                                                                                                                                                 |
|------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1                | Master i Shkencave.<br>Master i Arteve.<br>Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.<br>Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë. |
| 2                | Master Profesional.<br>Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.                                                                                                                                                          |
| 3                | Bachelor.<br>Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.                                                                                                                                                                    |

Lidhja nr. 3


**Klasat e pagave të punonjësve administrativë të AIDA-s**

| Pozicioni                 | Klasa |
|---------------------------|-------|
| Punonjës Pastrimi/Sanitar | I     |
| Shofer                    | IV    |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE  
BORDI DREJTUES

Lidhja nr. 4





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE  
BORDI DREJTUES

|                                                             |           |           | LIDHJA NR. 5 |
|-------------------------------------------------------------|-----------|-----------|--------------|
| ORGANIKA E AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE |           |           |              |
| POZICIONI                                                   | KATEGORIA | NUMRI     |              |
| <b>1 DREJTOR EKZEKUTIV</b>                                  | II-a      | <b>1</b>  |              |
| <b>2 DREJTORIA E INVESTIMEVE</b>                            |           | <b>13</b> |              |
| DREJTOR                                                     | II-b      | 1         |              |
| <b>2.1 SEKTORI I INVESTIMEVE DHE AFTER CARE</b>             |           | <b>8</b>  |              |
| PËRGJEGJËS SEKTORI                                          | III-a     | 1         |              |
| SPECIALIST                                                  | III-b     | 7         |              |
| <b>2.2 SEKTORI ONE STOP SHOP</b>                            |           | <b>4</b>  |              |
| PËRGJEGJËS SEKTORI                                          | III-a     | 1         |              |
| SPECIALIST                                                  | III-b     | 3         |              |
| <b>3 DREJTORIA MARKETING DHE KËRKIM ANALIZË</b>             |           | <b>5</b>  |              |
| DREJTOR                                                     | II-b      | 1         |              |
| SPECIALIST                                                  | III-b     | 4         |              |
| <b>4 DREJTORIA E KOORDINIMIT</b>                            |           | <b>4</b>  |              |
| DREJTOR                                                     | II-b      | 1         |              |
| SPECIALIST                                                  | III-b     | 3         |              |
| <b>5 DREJTORIA E NVM DHE PROJEKTEVE</b>                     |           | <b>8</b>  |              |
| DREJTOR                                                     | II-b      | 1         |              |
| <b>5.1 SEKTORI I NVM DHE EKSPORTEVE</b>                     |           | <b>4</b>  |              |
| PËRGJEGJËS SEKTORI                                          | III-a     | 1         |              |
| SPECIALIST                                                  | III-b     | 3         |              |
| <b>5.2 SEKTORI I INOVACIONIT DHE PROJEKTEVE</b>             |           | <b>3</b>  |              |
| PËRGJEGJËS SEKTORI                                          | III-a     | 1         |              |
| SPECIALIST                                                  | III-b     | 2         |              |
| <b>6 DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>                 |           | <b>8</b>  |              |
| DREJTOR                                                     | II-b      | 1         |              |
| SPECIALIST (JURIST)                                         | IV-a      | 1         |              |
| SPECIALIST (BURIME NJERËZORE)                               | IV-a      | 1         |              |
| SPECIALIST (FINANCË/BUXHET)                                 | IV-a      | 1         |              |
| ARKIV/PROTOKOLL                                             | IV-b      | 1         |              |
| PUNONJËS PASTRIMI                                           |           | 1         |              |
| SHOFER                                                      |           | 2         |              |
| <b>PUNONJËS GJITHSEJ</b>                                    |           | <b>39</b> |              |